

Në bazë të nenit 23 paragrafit (7) të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17 dhe 64/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20, 269/23, 78/25, 132/25 dhe 250/25), ministri i Arsimit dhe Shkencës solli

K A L E N D A R

për organizimin dhe punën e shkollave të mesme publike në vitin shkollor 2026/2027

Neni 1

Me këtë kalendar përcaktohet organizimi dhe puna e shkollave të mesme publike, në përputhje me tërësitë programore gjatë vitit mësimor: gjysmëvjetori, format e tjera të veprimtarisë edukativo-arsimore dhe pushimi i nxënësve në vitin shkollor 2026/2027.

Neni 2

Viti shkollor në shkollat e mesme publike fillon më 1 shtator 2026 dhe përfundon më 31 gusht 2027.

Viti mësimor fillon më 1 shtator 2026 dhe përfundon më 10 qershor 2027, përveç nxënësve të vitit përfundimtar të arsimit të mesëm gjimnaz, arsimit profesional me kohëzgjatje katërvjeçare dhe trevjeçare, si dhe arsimit artistik, për të cilët mësimi i rregullt përfundon më 17 maj 2027.

Neni 3

Viti mësimor përbëhet nga dy gjysmëvjetorë – gjysmëvjetori i I dhe II.
Gjysmëvjetori i parë fillon më 1 shtator 2026 dhe përfundon më 30 dhjetor 2026.
Gjysmëvjetori i dytë fillon më 21 janar 2027 dhe përfundon më 10 qershor 2027.

Neni 4

Gjatë vitit shkollor, nxënësit shfrytëzojnë pushimin dimëror dhe pushimin veror.

Pushimi dimëror i nxënësve fillon më 31 dhjetor 2026 dhe përfundon më 20 janar 2027.

Gjatë pushimit dimëror, të punësuarit në shkollë, përveç personelit ndihmës-technik, i cili është i domosdoshëm për sigurimin e objekteve dhe pronës së shkollave, nga 4 janari deri më 12 janar 2027 shfrytëzojnë ditë të paguara jopune.

Pushimi veror i nxënësve fillon më 11 qershor 2027 dhe përfundon më 31 gusht 2027.

Neni 5

Për nxënësit e viteve përfundimtare të arsimit të mesëm, shkollat e mesme publike, në periudhën nga 18 maji deri më 28 maj 2027, organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera të ndihmës për nxënësit të cilët duhet t'u nënshtrohen provimeve përmirësuese, provimeve të vitit dhe provimeve plotësues.

Për nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni, shkollat e mesme publike organizojnë dhënien e provimeve përmirësuese, provimeve të vitit dhe provimeve plotësuese në afatin e provimeve të qershorit, në periudhën nga 1 qershori deri më 4 qershor 2027.

Për nxënësit e viteve përfundimtare të arsimit të mesëm, të cilët i nënshtrohen maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale, maturës shtetërore artistike, maturës shkollore-gjimnaz, maturës shkollore profesionale, maturës shkollore artistike ose provimit përfundimtar në afatin e provimeve të gushtit, shkollat e mesme publike organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera të ndihmës për nxënësit të cilët duhet t'u nënshtrohen provimeve përmirësuese, provimit të vitit, provimeve plotësuese dhe provimeve për përparim më të shpejtë, në periudhën nga 15 qershori deri më 22 qershor 2027.

Për nxënësit nga paragrafi (3) i këtij neni, shkollat e mesme publike, në afatin e provimeve të qershorit, organizojnë dhënien e provimeve përmirësuese, provimeve të vitit, provimeve plotësuese dhe provimeve për përparim më të shpejtë, në periudhën nga 23 qershori deri më 25 qershor 2027.

Shkollat e mesme publike organizojnë mësim përgatitor, konsultime dhe forma të tjera të ndihmës për nxënësit të cilët duhet t'u nënshtrohen provimeve përmirësuese, provimit të vitit, provimeve plotësuese dhe provimeve për përparim më të shpejtë, në periudhën nga 15 qershori deri më 22 qershor 2027 dhe nga 11 gushti deri më 16 gusht 2027, për nxënësit e vitit të parë, të dytë dhe të tretë.

Për nxënësit nga paragrafi (5) i këtij neni, shkollat e mesme publike, në afatin e provimeve të qershorit, organizojnë dhënien e provimeve përmirësuese, provimeve të vitit, provimeve plotësuese dhe provimeve për përparim më të shpejtë, në periudhën nga 23 qershori deri më 30 qershor 2027, ndërsa në afatin e provimeve të gushtit, në periudhën nga 17 gushti deri më 20 gusht 2027.

Neni 6

Provimet eksterne të maturës shtetërore në afatin e provimeve të qershorit realizohen në këto data:

- Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 11 qershor 2027, me fillim në orën 9:00.
- Gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane, përkatësisht matematikë, më 29 maj 2027, me fillim në orën 9:00.

Për nxënësit nga paragrafi (1) i këtij neni, të cilët në afatin e provimeve të qershorit nuk kanë dhënë me sukses një pjesë ose të gjitha provimet e maturës shtetërore, ose për arsye të arsyeshme nuk i janë nënshtruar një pjese ose të gjitha provimeve të maturës shtetërore, organizohet afati i provimeve të gushtit, në këto data:

- Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 13 gusht 2027, me fillim në orën 9:00;
- Gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane, përkatësisht matematikë, më 11 gusht 2027, me fillim në orën 9:00.

Provimet eksterne të maturës shtetërore profesionale në afatin e provimeve të qershorit realizohen në këto data:

- Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 14 qershor 2027, me fillim në orën 9:00.
- Gjuhë angleze, përkatësisht matematikë, më 5 qershor 2027, me fillim në orën 9:00.

Për nxënësit nga paragrafi (3) i këtij neni, të cilët në afatin e provimeve të qershorit nuk kanë dhënë me sukses një pjesë ose të gjitha provimet e maturës shtetërore profesionale, ose për arsye të arsyeshme nuk i janë nënshtruar një pjese

ose të gjitha provimeve të maturës shtetërore profesionale, organizohet afati i provimeve të gushtit, në këto data:

- Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 13 gusht 2027, me fillim në orën 9:00;
- Gjuhë angleze, përkatësisht matematikë, më 11 gusht 2027, me fillim në orën 9:00.

Provimet eksterne të maturës shtetërore artistike në afatin e provimeve të qershorit realizohen në këto data:

- Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 14 qershor 2027, me fillim në orën 9:00.
- Gjuhë angleze, përkatësisht histori, më 5 qershor 2027, me fillim në orën 9:00.

Për nxënësit nga paragrafi (5) i këtij neni, të cilët në afatin e provimeve të qershorit nuk kanë dhënë me sukses një pjesë ose të gjitha provimet e maturës shtetërore artistike, ose për arsye të arsyeshme nuk i janë nënshtruar një pjesë ose të gjitha provimeve të maturës shtetërore artistike, organizohet afati i provimeve të gushtit, në këto data:

- Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 13 gusht 2027, me fillim në orën 9:00;
- Gjuhë angleze, gjuhë frënge, gjuhë gjermane, gjuhë ruse, gjuhë italiane, përkatësisht matematikë, më 11 gusht 2027, me fillim në orën 9:00.

Provimet interne nga pjesa zgjedhore e maturës shtetërore, maturës shtetërore profesionale dhe maturës shtetërore artistike zhvillohen në datat e përcaktuara nga Komisioni i maturës së shkollës, edhe atë:

- Në afatin e provimeve të qershorit, në periudhën nga 17 qershori deri më 25 qershor 2027;
- Në afatin e provimeve të gushtit, në periudhën nga 16 gushti deri më 24 gusht 2027.

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese për nxënësit e arsimit të mesëm gjimnaz, arsimit profesional dhe arsimit artistik, në afatin e provimeve të qershorit, realizohet në periudhën nga 1 prilli deri më 11 maj 2027, ndërsa në afatin e provimeve të gushtit, nga 16 gushti deri më 24 gusht 2027.

Neni 7

Matura shkollore - gjimnaz, matura shkollore profesionale dhe matura shkollore artistike realizohen në tri afate të provimeve, përkatësisht: qershor, gusht dhe janar.

Në afatin e provimeve të qershorit:

- Pjesa e detyrueshme (gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe), më 15 qershor 2027, me fillim në orën 9:00.

Në afatin e provimeve të gushtit:

- Pjesa e detyrueshme (gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe), më 16 gusht 2027, me fillim në orën 9:00.

Provimi nga pjesa zgjedhore e maturës shkollore- gjimnaz, maturës shkollore profesionale dhe maturës shkollore artistike realizohen në datat e përcaktuara nga Komisioni i maturës së shkollës, edhe atë:

- Në afatin e provimeve të qershorit, në periudhën nga 17 qershori deri më 25 qershor 2027;
- Në afatin e provimeve të gushtit, në periudhën nga 16 gushti deri më 24 gusht 2027.

Prezantimi dhe mbrojtja e detyrës projektuese për nxënësit e arsimit të mesëm gjimnaz, profesional dhe artistik, në afatin e provimeve të qershorit realizohet në periudhën nga 1 prilli deri më 11 maj 2027, ndërsa në afatin e provimeve të gushtit, nga 16 gushti deri më 24 gusht 2027.

Në afatin e janarit – gjatë pushimit dimëror të nxënësve, në datat e përcaktuara nga Komisioni i maturës së shkollës.

Neni 8

Provimi përfundimtar në arsimin profesional trevjeçar realizohet në tri afate të provimeve, përkatësisht: afati i qershorit, afati i gushtit dhe afati i janarit.

Në afatin e provimeve të qershorit:

- Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 15 qershor 2027, me fillim në orën 9:00.

Në afatin e provimeve të gushtit:

Gjuhë dhe letërsi maqedonase, gjuhë dhe letërsi shqipe, gjuhë dhe letërsi turke, përkatësisht gjuhë dhe letërsi serbe, më 16 gusht 2027, me fillim në orën 9:00.

Në afatin e provimeve të janarit – gjatë pushimit dimëror të nxënësve, në datat e përcaktuara nga Komisioni i maturës së shkollës.

Puna praktike individuale në arsimin profesional trevjeçar zhvillohet në datat e përcaktuara nga Komisioni i maturës së shkollës, me propozim të komisioneve përkatëse lëndore të shkollës.

Neni 9

Puna edukativo-arsimore për nxënësit organizohet gjatë gjithë javës së punës, përveç gjatë festave shtetërore, festave të tjera dhe ditëve jopune të përcaktuara me ligj.

Neni 10

Gjatë vitit mësimor, në shkollat e mesme publike, për vitin e fundit të arsimit realizohen të paktën 163 ditë mësimore, ndërsa për të gjitha vitet e tjera të arsimit realizohen të paktën 180 ditë mësimore.

Neni 11

Në Ditën e shkollës organizohen veprimtari kulturore, sportive dhe manifestime të tjera.

Dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët e bashkësive që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase shënohet me organizimin e veprimtarive kulturore dhe manifestimeve të tjera.

Dita e shkollës dhe dita tradicionale e arsimit për pjesëtarët e bashkësive që ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase janë ditë mësimore, gjatë të cilave realizohen programe të veçanta.

Neni 12

Ditët e punës gjatë të cilave zhvillohen ekskursione shkollore të nxënësve konsiderohen ditë mësimore, gjatë të cilave realizohen programe të veçanta.

Për nxënësit që nuk marrin pjesë në ekskursione, shkolla organizon mësim të rregullt, në përputhje me orarin e orëve mësimore.

Neni 13

Praktika feriale realizohet në varësi të specifikave të kualifikimit dhe sektorit dhe realizohet gjatë pushimeve verore të nxënësve, përveç nxënësve me korrespondencë, të cilët mund ta realizojnë atë edhe gjatë vitit shkollor.

Neni 14

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij kalendari, pushon së vlefshmi Kalendar për organizimin dhe punën e shkollave të mesme publike për vitin shkollor 2025/2026 („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 161/25 dhe 182/25).

Neni 15

Ky kalendar hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“, ndërsa do të fillojë të zbatohet prej më 1 shtator 2026.

Numër: 13-_9854/3

7 gusht 2026

Shkup

Министерка за образование

и наука,

Ministre e Arsimit dhe Shkencës

проф. д-р Весна Јаневска